



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1219/10 prot

Datë 01.08.2022

**V E N D I M**

**Nr. 737/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.08.2022 me

**Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “STUDIO SERVICES ” K - SA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim konsulence*” me Nr. REF-27371-05-04-2022 me objekt “*Hartim projekti rehabilitimi rrugës “Kasem Durrësi”*” me fond limit 2,472,686.00 (dy milion e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “STUDIO SERVICES ” K - SA” SHPK.  
Adresa: Lagjja 3, Rruga Egnatia dhe Rruga Ramazan Jella, Pallati 1125, Kati i parë, Durrës.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës  
Adresa: Sheshi “Liria”, 2000 Durrës

**Baza Ligjore:** Nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të

Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë të Komisionit, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.05.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Shërbim konsulence*” me Nr. REF-27371-05-04-2022 me objekt “*Hartim projekti rehabilitimi rrugës “Kasem Durrësi”*” me fond limit 2,472,686.00 (dy milion e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 20.05.2022 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton, se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit).

II.3. Në datën 07.06.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ku rezulton se operatori ekonomik “STUDIO SERVICES " K - SA” SHPK është i skualifikuar:

Operatorët ekonomikë të kualifikuar:

-Taulant SHPK

- Infratech SHPK
- Instituti Dekliada-Alb SHPK
- Net-Group SHPK
- Tower SHPK

Operatorët ekonomikë të skualifikuar:

- Dricons SHPK
- CEC Group SHPK
- Engineering Consulting Group SHPK
- Grama SHPK
- BOE Mag Partners SHPK & Civil Cons SHPK & Studio Archimed SHPK
- Novatech Studio SHPK
- Sphaera SHPK
- Studio Services K-SA SHPK

II.4. Në datën 07.06.2022 operatori ekonomik “STUDIO SERVICES ” K - SA” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

*-Nuk përmbush pikën 2.3.a të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 1’600’000 lekë”, pasi nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se në përmbushje të këtij kriteri janë paraqitur shërbime jo të ngjashme me objektin e prokurimit.*

II.5. Referuar sistemit të ankesave elektronike rezulton, se në datën 08.06.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2022/2266 dhe me nr. 1219/2022 prot., datë 08.06.2022 e operatorit ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES ” K - SA” SHPK, sipas të cilës kërkon shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “STUDIO SERVICES ” K - SA” SHPK A, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi..

II.6. Bazuar në pikën 3 të nenit 112 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 1219/2022/2 prot., datë 09.06.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES ” K - SA” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 2978/7 prot, datë 29.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1219/3 prot., datë 01.07.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.8. Në përfundim të afatit 5 ditor brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 1219/4 prot., datë 05.07.2022 i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në përputhje me përcaktimet e nenit 114 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

II.9. Me shkresën nr. 2978/10 prot, datë 05.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1219/5 prot., datë 07.07.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Kërkesë për asistencë”, mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.10. Me shkresën nr. 6006 prot, datë 06.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1219/6 prot., datë 08.07.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.11. Me shkresën nr. 2978/13 prot, datë 12.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1219/7 prot., datë 14.07.2022, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.12. Me shkresën nr. 4796/1 prot, datë 14.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1219/8 prot., datë 18.07.2022, Agjencia e Prokurimit Publik ka dërguar për dijeni pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Kthim-përgjigje” për autoritetin kontraktor Bashkia Durrës mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.13. Në datën 13.07.2022 nëpërmjet postës elektronike të KPP-së (info Komisioni) është dërguar në mënyrë elektronike vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nëpërmjet shkresës nr. 2978/14 prot, datë 13.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1219/9 prot., datë 18.07.2022. Autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar aktit të trajtimit të ankesës rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur **pranimin plotësisht të ankesës** së operatorit ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES " K - SA” SHPK.

II.14. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe në sistemin e ankesave elektronike, argumente nga operatorë ekonomikë të interesuar lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES " K - SA” SHPK, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

## **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES ” K - SA” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Nuk përmbush pikën 2.3.a të Kapacitetit Teknik, ku citohet se “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 1’600’000 lekë”, pasi nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet, se në përmbushje të këtij kriteri janë paraqitur shërbime jo të ngjashme me objektin e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në datën 13.07.2022 nëpërmjet postës elektronike të KPP-së (info Komisioni) është dërguar në mënyrë elektronike vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nëpërmjet shkresës nr. 2978/14 prot, datë 13.07.2022, protokolluar me tonën me nr. 1219/9 prot., datë 18.07.2022. Autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin mbi procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Referuar aktit të trajtimit të ankesës rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur **pranimin plotësisht të ankesës** së operatorit ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES ” K - SA” SHPK.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) *në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

i. *për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*

ii. *e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

b) *në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

c) *në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES ” K - SA” SHPK për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence” me Nr. REF-27371-05-04-2022 me objekt “Hartim projekti rehabilitimi rrugës “Kasem Durrësi” me fond limit 2,472,686.00 (dy milion e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES ” K - SA” SHPK.
  4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**